

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	02.04.2025	E/i nderuar zonja / zotëri! Drejtuese e këtij institucioni mjaft të rendësishëm për trashëgiminë. Unë avokat ***** në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të SHKA " Polifonia Shqiptare”si dhe shoqatës “Labëria”, për mbrojtjen e kulturës dhe të trashëgimisë “Polifonia Shqiptare” ju drejtohem me anë të kësaj kërkese, për të vënë në dispozicion një kopje të dosjes së vendimarrjes lidhur me shpalljen e "Iso -Polifonisë Shqiptare" si pjesë e trashëgimisë kulturore jomateriale të UNESCO-s. Duke patur parasysh rendësinë e këtij vendimi, për ruajtjen dhe promovimin e kësaj pasurie kulturore kërkoj: Të më vihet në dispozicion dokumentacioni përkatës	02.04.2025	Përsëndetje, Duke ju falenderuar për kërkesën e paraqitur, ju bëjmë me dije se ne nuk e disponojmë dosjen e kërkuar prej jush, si dhe ndonjë dokument të përshtatshëm nga ana juaj në kërkesën e paraqitur. Ju falenderojmë për interesimin dhe njëkohësisht për barrën e marrë përsipër, sikundër shkruani, për të siguruar mbrojtjen e mëtejshme të kësaj trashëgimie. Shoqatat që ju përfaqësoni shpresojmë që të bëhen pjesë e aktiviteteve që organizon Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale përgjatë programit të saj vjetor	E plotë	Nuk ka

		përfshirë: 1. Dosjen e aplikimit dhe dokumentet shoqëruese të dorëzuara pranë UNESCO-s. 2. Vendimin dhe procesverbalet e shqyrtimit nga organet kompetente. 3. Çdo raport analizë apo dokumentacionin mbështetës mbi kriteret dhe argumentimin e këtij statusi. 4. Cdo komunikim ndërinstitutional mbi këtë çështje. Kjo kërkesë bëhet me qëllim studimi të thelluar të procesit dhe për ta siguruar mbrojtjen e mëtejshme të kësaj trashëgimie kulturore. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe përkushtimin tuaj në ruajtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare pres me interes përgjigjen tuaj!		duke u bërë bashkë me udhën e përbashkët të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë sonë kulturore jomateriale.		
2.	16.04.2025	Përshëndetje, Uroj të jeni mirë. Quhem****anëtare e Këshillit Bashkiak Konispol. Në kuadër të një nisme të Bashkisë Konispol, për të regjistruar Vallen e Osman Takës në Regjistrin Kombëtar	30.04.2025	Përshëndetje, E nderuar znj.*****, Lidhur me kërkesën tuaj për regjistrimin e Valles së Osman Takës në Regjistrin Kombëtar të	E plotë	Nuk ka

		të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, jam ngarkuar unë me detyrën për të plotësuar materialet e nevojshme. Prej disa ditësh po përpiqem të regjistrohem në webin e Regjistri Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, por sistemi nuk e përfundon kurrë regjistrimin. A mund të më asistoni me hapat që duhet të ndjek dhe me dokumentacionin e nevojshëm që duhet të plotësoj ju lutem? Faleminderit dhe punë të mbarë!		Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe vështirësitë e hasura gjatë këtij procesi ju informojmë se çështja është përcjellë fillimisht pranë MEKI, në Drejtorinë e Politikave për Trashëgiminë Kulturore dhe më pas nga ana e tyre është adresuar për ndjekje pranë Tok Digital. Nga ana e strukturës përgjegjëse është konfirmuar marrja në shqyrtim e problematikës suaj dhe po punohet për zgjidhjen e saj dhe do ju njoftojmë për ecurinë. Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe angazhimin tuaj në promovimin e trashëgimisë sonë kulturore jomateriale.		
3.	18.04.2025	Përshëndetje, Po ju shkruaj nga Kaçaniku, jam drejtor i ansamblit të këngëve dhe valleve “Gryka e Kaçanikut”, desha të shpreh interesim për	18.04.2025	I nderuar, Ju falënderojmë për interesimin për të marrë pjesë në aktivitetet që organizohen nga Qendra Kombëtare e	E plotë	Nuk ka

		pjesëmarrje në aktivitetet e juaja kurdo që keni mundësi pasi që kemi dëshirë të promovojmë punën tonë në qytetet e Shqipërisë. Faleminderit!		Veprimtarive Tradicionale. Është gjithmonë e mirëpritur të kemi kontakte me grupe artistike që kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë kulturore jomateriale. Ju sigurojmë se institucioni ynë do të mbajë në konsideratë këtë interesim dhe do të ketë kënaqësinë t'ju ftojë në aktivitetet që organizon, kurdoherë që tëkrijohet një mundësi e përshtatshme për përfshirjen e ansamblit tuaj në programin artistik si përshëndetës dhe jo konkurrues, pasi ne organizojmë aktivitete kombëtare që do të thotë brenda Republikës së Shqipërisë dhe konkurrimi është mes grupeve të vendit. Vlerësojmë dëshirën tuaj për të prezantuar punën artistike në qytete të		
--	--	---	--	---	--	--

				ndryshme të Shqipërisë dhe jemi të hapur ndaj bashkëpunimeve që pasqyrojnë dhe forcojnë lidhjet kulturore mes trevave shqiptare. Promovimi i vlerave tona të përbashkëta kulturore është një nga synimet kryesore të QKVT-së, ndaj bashkëpunime të tilla janë gjithmonë të mirëpritura. Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe përkushtimin tuaj në promovimin e vlerave tona kulturore, mbetemi të gatshëm për çdo komunikim të mëtejshëm.		
--	--	--	--	---	--	--

4.	26.04.2025	Përshëndetje, Në kuadër të një projekti të mbështetur nga MEKI, në lidhje me një panair artizanësh në Gramsh dhe një tryezë të rrumbullakët në lidhje me të drejtat e autorit dhe trashëgiminë kulturore, i cili do të realizohet në sheshin para Bashkisë Gramsh, ju kontaktoj për të kërkuar ndihmën tuaj për sa më poshtë: - Nga Ministria u informova në lidhje me faktin që ju keni databazë të artizanëve në kuadër të veprimtarisë tuaj; - Kam bërë disa kontakte përmes Bashkisë Gramsh, por do ju lutesha nëse mund të më vini në dispozicion kontakte, pjesë e databazës tuaj, që ndodhen në zonën e Gramshit, për t'i kontaktuar dhe ofruar mundësinë e pjesëmarrjes në këtë projekt; gjithashtu nëse ju vlerësoni të përshtatshme të kontaktohen përmes jush, gjithashtu jam	29.04.2025	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës suaj në lidhje me projektin për panairin e artizanëve dhe tryezën e rrumbullakët që do të zhvillohet në qytetin e Gramshit, ju bëjmë me dije se: Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale e mbështet çdo përpjekje për ruajtjen dhe fuqizimin e komuniteteve artizanale në të gjithë vendin. Lidhur me kërkesën tuaj për kontaktet e artizanëve të zonës së Gramshit, ju informojmë se në përputhje me Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe në respekt të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk është e mundur të vihen në dispozicion të dhënat personale të kontakteve mobil pa pëlqimin e	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	---------	--------

		disponibël të ndajmë bashkë invitation dhe application form, ose çdo gjë tjetër që ju mendoni të nevojshme. Po bashkëngjis dhe një kopje të posterit të eventit; data mund të rishikohet. Faleminderit!		shprehur paraprakisht të individëve të përfshirë. Sipas Regjistrit Kombëtar të Artizanëve, që ndodhet në institucionin tonë, po ju vemë në dispozicion emrat e artizanëve nga Gramshi, të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve tona publike, gjatë organizimeve të edicioneve të "Panairit Kombëtar të Artizanatit" që zhvillohet çdo vit nga QKVT. Artizanët nga Gramshi në Regjistrin Kombëtar të Artizanëve, pranë QKVT: 1. Z. Abedin Ballolli 2. Z. Mirnel Lubinja 3. Znj. Mirushe Lumshi 4. Z. Neim Sharku 5. Z. Vullnet Hoxha Mbetemi në dispozicion për çdo nevojë të mëtejshme.	
--	--	--	--	--	--

5.	26.05.2025	Shpresoj që ky email t'ju gjeje mirë. Ju drejtohem në lidhje me mundësinë për të qenë pjesë e institucionit tuaj. Kam kënaqësinë t'ju dërgoj bashkëngjitur CV-në time, ku pasqyrohet përvoja ime disa vjeçare në fusha të ndryshme artistike. Ju falenderoj për mundësinë që na jepni. Mbetem në dispozicion për çdo informacion shtesë. Me respekt, ****	27.05.2025	Përsëndetje, I nderuar z.**** Ju falenderojmë për interesimin tuaj për aplikimin për pozicionin “Ekspert Vlerësues i Vlerave Kulturore, të Pasurive Jomateriale”. Ju informojmë se për të qenë pjesë e procesit të përzgjedhjes është e nevojshme të dorëzohet dokumentacioni i plotë i kërkuar për aplikim. Lutemi të dorëzoni si më poshtë: Në adresën elektronike: Info@folklor.gov.al Si dhe në adresën fizike të institucionit: Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Kinostudio - rruga "Gëzim Erebara" pranë pallatit nr. 31 Tiranë. Listën e dokumenteve të kërkuara për aplikim	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

				mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm: https://folklor.gov.al/kriteret/ Ju rikujtojmë se afati për dorëzimin e aplikimeve është deri më datën 20 qershor 2025. Më tutje do të vijojë faza e shqyrtimit të dokumentacionit. Për çdo sqarim të mëtejshëm, mbetemi në dispozicion.		
6.	29.05.2025	Përshëndetje, Emrin e kam ****, jam Amerikan por kam jetuar në Shqipëri dhe në Kosovë 2022-2024. Jam student te Brigham Young University dhe jam pjesë të një grupi vallëzimi kultural te universiteti im. Dua të studioj valle Shqiptare dhe shpresoj të gjej mësues/grupe nga të cilat mund të mësoj me një grup të vogël valltarësh nga universiteti im në verën e vitit tjetër.	29.05.2025	Përshëndetje, I nderuar z. **** Fillimisht ju falenderojmë për interesimin e treguar për të mësuar valle popullore, një pjesë e vyer e trashëgimisë sonë kulturore dhe identitetit kombëtar. Ju bëjmë me dije se Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale (QKVT) nuk ofron aktualisht programe apo kurse për mësimin e	E plotë	Nuk ka

		A mund të më ndihmoni të gjej grupe apo shoqata që e ruajnë folklorin e valles Shqiptare dhe që ofrojnë kurse apo në ndonjë mënyrë tjetër mund të na jepnin mësim? Shumë faleminderit,****		valleve popullore. Megjithatë, për t'ju përgjigjur interesimit tuaj, ju sugjerojmë të kontaktoni z. Genc Kastrati, mjeshtër i valleve, i cili aktualisht punon pranë Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor. Ai angazhohet në mënyrë të vazhdueshme me ruajtjen dhe përcjelljen e traditës sonë koreografike. Mund të kontaktoni përmes adresës elektronike: Email: gencikastrati@gmail.com Ose numri të kontaktit +355697899233 Ai mund t'ju udhëzojë dhe ofrojë më shumë informacion në lidhje me mundësitë e mësimi të valleve popullore. Duke ju falenderuar, Ju urojmë gjithë të mirat!	
--	--	--	--	---	--

7.	06.06.2025	Përshëndetje *****, Uroj të jeni mirë. Po ju kontaktojmë pasi do të na duhet një informacion lidhur me një event që keni postuar se do të zhvillohet në Laç - Panairi Kombëtar i Artizanatit, pasi kemi disa klient që interesohen në këtë event dhe donin informacion në rast se do të zhvillohet apo jo. Mbetem në pritje të përgjigjes tuaj. Faleminderit, *****	09.06.2025	Përshëndetje, Të nderuar ***** Ju falënderojmë për interesimin tuaj në lidhje me Panairin Kombëtar të Artizanatit, i cili pritet të zhvillohet në qytetin e Laçit. Ju bëjmë me dije se ky aktivitet është parashikuar të mbahet në fund të muajit shtator 2025, në kuadër të 29 Shtatorit – Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, një datë e rëndësishme për evidentimin dhe promovimin e vlerave tona kulturore. Aktualisht, detajet organizative janë ende në proces, dhe jemi në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e Bashkisë Kurbin, me qëllim përcaktimin dhe harmonizimin e të gjitha elementeve të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit.	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

				Sapo të finalizohen të gjitha detajet, do të informoheni zyrtarisht përmes kanaleve tona të komunikimit. Ju ftojme ndërkohë të na ndiqni në rrjetet tona sociale në facebook (Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale) dhe instagram (foklori.al) , ku do të publikojmë rregullisht përditësime dhe informacion mbi panairin. Ky aktivitet përfaqëson një nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore në nivel kombëtar, me qëllim promovimin, ruajtjen dhe mbështetjen e trashëgimisë sonë artizanale dhe mjeshtëreve shqiptarë. Duke ju falenderuar, Ju urojmë punë të mbarë!		
--	--	--	--	---	--	--

8.	16.07.2025	Ansambli Folklorik VAÇE ZELA Fier-Shegan, Lushnjë në 29-30 shtator 2024 ka marrë pjesë në Festivalin Folklorik Tipologjik të Sazeve Popullore ne Ersekë dhe në 23-24 qershor 2025 në Festivalin Folklorik Tipologjik të Valles Popullore. Për të dyja këto festivale kërkojmë të na pajisni me Çertifikatë, si pjesëmarrës në këto festivale. Në raste të tjera kur jemi vlerësuar me çmim evidentohet pjesëmarrja në festival, ndërsa në rastin konkret në dy festivalet e fundit na mungon modeli i certifikatës që ju lëshoni për pjesëmarrje në këto festivale. Kërkesa jonë lidhet me evidentimin ndër vite për arkiv dhe për ekspozim në albumet tona për pjesëmarrjen e ansamblit në veprimtari kombëtare. Drejtori Artistik *****	21.07.2025	I nderuar z. ***** Lidhur me kërkesën tuaj, drejtuar nesh me anë të postës elektronike zyrtare të institucionit tonë, Info@folklor.gov.al, më datën 16 korrik 2025, për pjesëmarrjen e Ansamblit Folklorik “Vaçe Zela” Fier-Shegan Lushnjë, ju bëjmë me dije si më poshtë: Ansambli Folklorik “Vaçe Zela” Fier-Shegan Lushnjë ka marrë pjesë në 1. Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar të Sazeve Popullore, Edicioni XIII i zhvilluar më datat 29-30 shtator në Leskovik, 1 tetor në Ersekë, në vitin 2024. 2. Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar të Valles Popullore, Edicioni XIII i zhvilluar në qytetin e Lushnjës, më 23-24 qershor 2025.	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

				Artistët popullorë pjesëmarrës të ansamblit tuaj në këto aktivitete janë pajisur prej nesh me certifikatë pjesëmarrjeje individuale. Aktivizimi juaj kontribuon në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë kulturore dhe njëkohësisht e shton ansamblin tuaj si bashkëpunëtor të vyer të institucionit tonë. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin me përkushtim.		
9.	17.11.2025	Unë që po ju shkruaj dr ***** Përgjegjësi i Muzeut të Lushnjes. Jam i interesuar (për llogari të Bashkisë Lushnje) për të futur si pasuri Kombëtare “Vallen e Ngjalës” A mund tmë dërgoni pikat që duhen plotësuar Faleminderit!	19.11.2025	Përrshëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për shpalljen e “Valles së Ngjalës” si Pasuri Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, ju bëjmë me dije se propozimi për këtë element realizohet përmes aplikimit në Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, sipas procedurës së përcaktuar për regjistrimin e elementeve.	E plotë	Nuk ka

				Bashkëngjitur po ju dërgojmë linkun për procedurën e aplikimit për Regjistrin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. https://regjistrickj.al/procedura-e-aplikimit-per-inventarin-kombetar-te-trashegimise-kulturore-jomateriale/ Njëkohësisht duhet pasur parasysh se, sipas "Konventës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale", UNESCO 2003, neni 11: "I përket çdo shteti palë: a) të marrë masat e nevojshme për të siguruar ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij; b) të ndërmarrë masat e ruajtjes... për të identifikuar dhe përcaktuar elementet e ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij, me pjesëmarrjen e bashkësive, të grupeve dhe të organizatave joqeveritare përkatëse." Bashkëlidhur gjeni detajimin e materialeve që duhen plotësuar. Faleminderit për përkushtimin tuaj në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Ju urojmë punë të mbarë!		
--	--	--	--	---	--	--

10.	20.11.2025	Përshëndetje, tentova të bëj regjistrimin por nuk u regjistrova dot.	25.11.2025	Përshëndetje, Ju informojmë se problematika e paraqitur lidhur me vështirësitë në procesin e regjistrimit në platformën online të Regjistrit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale është referuar pranë Drejtorisë së Politikave për Trashëgiminë Kulturore, e cila po merr masat e nevojshme për rregullimin e sistemit. Ndërkohë, për të vijuar pa vonesa me procedurën, ju lutemi të përgatisni dokumentacionin për “Vallen e Ngjalës”, sipas udhëzimeve dhe materialeve të përcjella më herët. Dokumentacioni mund të dorëzohet pranë institucionit tonë fizikisht ose në rrugë postare, në adresën: Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale Rruga “Bulevardi Zogu I”, ndërtesa 7, hyrja 4, apartamenti nr. 8, Tiranë. Faleminderit dhe punë të mbarë!	E plotë	Nuk ka
-----	------------	--	------------	---	---------	--------